



Nr. 16282 Prot.

Tiranë, më 2/9/2020

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVË

Nr. 106 Datë 2.9.20

**PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQERIVE ;
“ ALBTURIST TO ” SHA; “ AEROPORTI NËNË TEREZA ” SHA TIRANË; “ NPV ” SHA
DURRËS; “ PRODHIM KABLLO ” SHA SHKODËR; “ KRIPA ” SHA VLORË; “ ELBER ” SHPK
ELBASAN NGA
“ PRODHIM MOBILJE ” SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ” i ndryshuar, statutit të shoqërive “Albturist To” sha Tiranë; “Aeroporti Nënë Tereza” sha Tiranë; “ NPV ” sha Durrës; “ Prodhim Kablo ” sha Shkodër; “ Kripa ” sha Vlorë ; “ Elber ” shpk Elbasan dhe “ Prodhim Mobilje ” sha Tiranë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërive;

VENDOSA:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje të shoqërive “Albturist To” sha, Tiranë; “Aeroporti Nënë Tereza” sha, Tiranë; “NPV” sha Durrës; “Prodhim Kablo” sha, Shkodër; “Kripa” sha, Vlorë ; “ Elber ” shpk, Elbasan; “Albturist To” sha, Tiranë; nga shoqëria “Prodhim Mobilje” sha, Tiranë.
2. Kapitali i shoqërisë përthithëse “Prodhim Mobilje” sha, Tiranë, bëhet 22,474,440.565 lekë, i përbërë nga 22,474,440.565 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Shoqëritë “Albturist To” sha, Tiranë; “Aeroporti Nënë Tereza” sha, Tiranë; “NPV” sha, Durrës; “ Prodhim Kablo ” sha, Shkodër; “Kripa” sha, Vlorë ; “ Elber ” shpk, Elbasan, pas përfundimit të bashkimit, vlerësohen të prishura, sipas nenit 220 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2014 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ndaj çregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V, të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2207, “Për regjistrimin e biznesit”.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Anila DENAJ